



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha

Elbasan, më: ____ . ____ . 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:
“Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë”

- Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rajoni Elbasan” sha**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Ofertuesi për t’u kualifikuar duhet të ketë në objektin e veprimtarisë së tij në shërbimin e kërkuar nga ana jonë: **“Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë”**, dhe në përputhje me specifikimet teknike të mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia	Specifikime
1	Makinë hapëse vrimash jo më pak se 30 fletë	copë	20	Të jetë cilësore, dhe të mundësojë hapjen e jo më pak se 30 fletë njëherësh
2	Kapëse me veshë 41 mm	copë	100	Të jenë cilësore, material metali sustë.
3	Kapëse me veshë 51 mm	copë	60	Të jenë cilësore, material metali sustë.
4	Gomë fshirëse	copë	30	Të jenë cilësore në fshirjen e bojës së stilolapsave dhe të lapsave.

5	Llastik lekësh	pako	20	Të jenë material cilësor, dhe rezistent në hapje.
6	Kapëse letrash flamur metal 33 mm	Kuti	30	Të jenë metalike me material cilësor.
7	Tela për kapëse 24/6	Kuti	60	Të jenë metalike me material cilësor.
8	Letër A4	Rizma	1608	<ul style="list-style-type: none"> - Letër fotokopje A4 (Një rizmë të ketë jo më pak se 500 fletë) - Pesha 80 gr/m². - Përmasat 210 mm x 297 mm. - Të jetë e cilësisë së parë sipas certifikimit ISO CIE (ose ekuivalente) - Lëmueshmëria 80 - 100 ml/min. - Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 rizma. - Lagështia: 3.5 % - 4.5 %. - (drita) >= 95%. - Dukshmëria - Shkëlqimi: 101-104% - Bardhësia: 157 – 163. - Ashpërsia në përkulje: >110mN DM - Trashësia 104 - 112 µm - Bardhësi: 152 - 160% dhe pa lustër - Të jetë multifunkionale - për fotokopje, printer, faks. - Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in - Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit - Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit - Të plotësojnë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë. - Të mos jetë e ricikluar - Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët - Të paraqitet një certifikate e letrës e cila pasqyron specifikimet e saj.
9	Stilolapsa Blu	copë	200	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, i veshur me material plastik, ngjyra blu
10	Stilolapsa të kuq	copë	50	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, i veshur me material plastik, ngjyra e kuqe
11	Lapsa Plumbi HB	copë	60	Të jenë cilësor, grafit të standartit HB të zakonshëm
12	Dosje me mekanizëm 5 cm	copë	30	Dosje me mekanizëm të jetë prej plastike, me trashësi 5 cm, përmasa afërsisht 31x29x5 cm (marzh gabimi 5%), të ketë të montuar bazamentin e fiksimit të dokumenteve.

13	Dosje me mekanizëm 7 cm	copë	70	Dosje me mekanizëm A4 me kuti, 28x35x7 cm (marzh gabimi 5%), me kuti, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.
14	Qese aktesh	Pako	100	Material plastik cilësor, format A4, me vrime. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe.
15	Blllok stiker	copë	40	Blllok shënimesh adesive 76x76, me 300 fletë me fletë me ngjyra
16	Makinë kapëse 24/6	copë	30	Makinë kapëse aktesh 24/6, metal + plastike. Të kapë jo më pak se 25 fletë.
17	Letër kase /printer termik (gjerësi 80 mm)	copë	400	Letër rulon për kasa /printer termik
18	Ngjitës rulon	copë	20	Të jetë material cilësor
19	Lagës gishti	copë	30	Tampon me sfungjer. Të jenë material cilësor
20	Makinë llogaritëse	copë	30	Të kenë përmasa jo më të vogla se 147 x 225 mm dhe jo më pak se 12 Digit, të kenë çelës për fikje ndezje. Të jenë prodhim i certifikuar nga CE.
21	Korrektor stilo	copë	30	Të jenë material cilësor.
22	Prefëse lapsash	copë	50	Të jenë material metalik ose plastik në trup, dhe teh cilësor në mprehjen e lapsave.
23	Vizore 30 cm	copë	60	Të jenë cilësore me material plastik të tejdukshëm.
24	Dosje A4 zarfe plastike	copë	20	Të jenë material plastik cilësor, me kapak dhe të pa depërtueshëm nga uji.
25	Dosje bene	copë	120	Të jenë material cilësor, dhe me kapëse metalike brenda dosjes.
26	Heqëse telash	copë	40	Të jenë material cilësor
27	Kit MK 1150 KYOCERA	copë	3	Page yield 100,000 pages Printer model ECOSYS M2040dn, ECOSYS M2135dn, ECOSYS M2540dn, ECOSYS M2635dn, ECOSYS M2640idw, ECOSYS M2735dw, ECOSYS P2040dn, ECOSYS P2040dw, ECOSYS P2235dn, ECOSYS P2235dw - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
28	TONER KYOCERA p 20-40 (TK 1160)	copë	10	Kyocera TK-1160 Black Toner Cartridge (7,200 Pages) for Kyocera ECOSYS P2040 Printers. Ensure your prints never dip in quality with the TK-1160 Black Toner Cartridge (7,200 Pages) - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
29	Toner HP 142 A për Printer HP Laserjet M109-M112	copë	2	HP 142A Black Original LaserJet Toner Cartridge, 950 pages, Black. - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
30	Toner HP 106A, për Printer HP MFP 135 A	copë	2	Product subgroup: Standard Capacity Toner Cartridges Color(s) of printing supplies: Black Page yield (color): ~1,000 pages.

				- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
31	Toner MP 2501 për Printer Ricoh MP 2501SP	copë	2	Ricoh MP 2501SP Black Toner Cartridge (Genuine) - Genuine Ricoh Brand - Estimated Yield 9,000 pages @ 6%. - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
32	Toner 51B00A0 për Printer Lexmark MS 317 dn	copë	2	Lexmark 51B00A0, Black toner cartridge, compatible, 2500 standard pages. - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
33	DRUM unit 50F0Z00 për Printer Lexmark MS 317 dn	copë	2	50F0Z00 Compatible Image Unit Drum For Lexmark MS310 410 510 610 MX 310 410 415 510 511 610 611 - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
34	Toner për Printer Lexmark MB 2236	copë	2	Toner cartridge, Type Manufacturer part # B220XA0 6000 faqe. - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
35	Image unit MB 2236 DW, B220Z00	copë	2	B220Z00 Imaging Unit Estimated Yield Up to: 12000 pages, based on 3 average letter/A4-size pages per print job and ~ 5% coverage - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
36	Genuine Ricoh Aficio MP 3352 Black Toner Cartridge	copë	3	Ricoh Aficio MP 3352 Black Toner Cartridge (Genuine), Estimated 11,000 pages. - E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

Siellim në vëmendje të OE, se:

- Tonerat të jenë origjinale (të vërteta) të certifikuara, të prodhuesve të pajisjes për të cilin kërkohet/ose ekuivalent, me vulë origjinaliteti, të pahapura, jo të rimbushura, të verifikueshme nëpërmjet pullës së sigurisë, bar-kodit dhe numrit serial (në rastet kur aplikohet).
- Tonerat duhet të kenë garanci përdorimi deri në dy vjet nga koha e hyrjes në magazinën e AK.
- Tonerat duhet të kenë të gdhendur në trup emrin e tonerit përkatës të cilët janë element sigurie.
- Tonerat të jenë cilësore, në përputhje me standartet CE.
- Tonerat duhet të kenë shiritat mbrojtës, të cilët janë element sigurie dhe hiqen me përdorimin e parë.
- Tonerat të jenë të mbështjella në qese në mënyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurt) dhe të ambalazhuara nëpër kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi.
- Transporti dhe fuqia e nevojshme punëtore për ngarkimin, shkarkimin dhe dorëzimin e artikujve në Magazinën qendrore të AK me adresë: Lagjja: “Mengël” Elbasan, do të bëhet nga OE.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në ligjin 162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 4, neni 36 dhe neni 77, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 i këtij vendimi.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Për artikujt e listuar në tabelën e mëposhtme, OE duhet të paraqesin mostra në datën dhe orën e hapjes së procedurës.

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia	Specifikime
1.	Letër A4	Rizma		<ul style="list-style-type: none"> - Letër fotokopje A4 (Një rizmë të ketë jo më pak se 500 fletë) - Pesha 80 gr/m². - Përmasat 210 mm x 297 mm. - Të jetë e cilësisë së parë sipas certifikimit ISO CIE (ose ekuivalente) - Lëmueshmëria 80 - 100 ml/min. - Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 rizma. - Lagështia: 3.5 % - 4.5 %. - Dukshmëria (drita) > = 95%. - Shkëlqimi: 101-104% - Bardhësia: 157 – 163. - Ashpërsia në përkulje: >110mN DM - Trashësia 104 - 112 µm - Bardhësi: 152 - 160% dhe pa lustër - Të jetë multifunksionale - për fotokopje, printer, faks. - Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in - Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit - Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit - Të plotësojnë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë. - Të mos jetë e ricikluar - Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët - Të paraqitet një certifikate e letrës e cila pasqyron specifikimet e saj.
2.	Makinë llogaritëse	copë		Të kenë përmasa jo më të vogla se 147 x 225 mm dhe jo më pak se 12 Digit, të kenë çelës për fikje ndezje. Të jenë prodhim i certifikuar nga CE.
3.	TONER KYOCERA p 20-40 (TK 1160)	copë	1	<p>Kyocera TK-1160 Black Toner Cartridge (7,200 Pages) for Kyocera ECOSYS P2040 Printers.</p> <p>Ensure your prints never dip in quality with the TK-1160 Black Toner Cartridge (7,200 Pages)</p>

4.	Toner 51B00A0 për Printer Lexmark MS 317 dn	copë	1	Lexmark 51B00A0, Black toner cartridge, compatible, 2500 standard pages
5.	Toner për Printer Lexmark MB 2236	copë	1	Toner cartridge, Type Manufacturer part # B220XA0 jo më pak se 6000 faqe

Shënim: Në datën dhe orën e hapjes së procedurës, mosparaqitja e mostrave të kërkuara nga AK, apo paraqitja e mostrave jashtë kërkesave të specifikuara, përbën kusht për s’kualifikim.

Autoriteti kontraktor, rezervon të drejtën që në momentin e marrjes në dorëzim të artikujve, nëse vëren se cilësia e materialeve nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara prej tij, apo ka dëmtime të ndryshme gjatë transportit, do ta kthejë atë dhe operatori ekonomik duhet të bëjë zëvendësimin e tyre brenda ditës, ose jo më vonë se dita e nesërme e punës, përjashtuar të shtunë të diel, apo ditë feste zyrtare. Në rast të mos përbushjes së kësaj kërkesë, OE s’kualifikohet.

Argumentimi: Me anë të kësaj kërkesë, Autoriteti Kontraktor do të garantohet nga OE, që i përbushin kërkesat e specifikimeve teknike, për çdo artikull të kërkuar për paraqitjen e mostrave. Mostrat e pranuar si të rregullta nga AK në datën dhe orën e hapjes së procedurës, do të shërbejnë edhe për krahasimin e të gjithë sasisë së furnizimit nga OE fitues, në zbatimin korrekt të kësaj kontrate.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 82 “Formulari i vetëdeklarimit”, dhe në nenin 83, “Sigurimi i ofertës”, si dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 dhe neni 30.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1, “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”, dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr. 9632 datë 30.10. 2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiakë të njësisve vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime).

Argumentimi: Ky kriter është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26, pika 2: “*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së.*”

2.1.3 Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime).

Argumentimi: Ky kriter mbështetet në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 14, pikat 2 dhe 3, si dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 88 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) për vitet (2020, 2021, 2022) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve

të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Ky kriter është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Në datën dhe orën e hapjes së ofertave, çdo OE pjesëmarrës, duhet të paraqesë mostrat e kërkuara nga AK, sipas tabelës në Shtojcën 5.

Mosparaqitja e mostrave, apo paraqitja e mostrave që nuk përputhen me specifikimet teknike, përbën kusht për s’kualifikim.

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”, si dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si

informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për përmbushjen e Specifikimeve Teknike.

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2: “Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.” dhe, në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 2: “Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim/deklaratë/autorizim prodhuesi ose të distributorit të autorizuar për artikujt e kancelarisë, bojë printeri (toner) dhe letrën. Dokumentet duhet të përmbajnë të dhëna të plota si: telefoni/e-mail/website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenet 36, dhe 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose vërtetimit ose dokumentit ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertojnë, është kërkesë e ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, duke ofruar dhe garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçantë e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin me sukses të kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

2.3.4 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit.

Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285, dt. 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40, pika 4: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes së nënshkruar mes palëve).

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në Ligjin 162/202 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”. Në këtë kërkesë AK ka parashtruar kërkesa minimale për të mos penalizuar OE që kanë interes të marrin pjesë në këtë procedurë.